



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

BORDI

RREGULLORE

PËR

**RREGULLAT E ORGANIZIMIT TË SISTEMIT TË ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT
NË SHOQËRINË E SIGURIMIT**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 18, datë 28.04.2015

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt rregullimin e organizimit dhe funksionimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 27, të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” (në vijim i referohemi si “ligji i sigurimeve”).

Neni 3

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë parimet minimale mbi bazën e të cilave shoqëria e sigurimit ndërton sistemin e administrimit të rrezikut, si dhe harton tërësinë e politikave dhe proceseve që lidhen me përcaktimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e rreziqeve.

Neni 4

Sistemi i administrimit të rrezikut

4.1 Për qëllime të kësaj rregulloreje “Sistemi i administrimit të rrezikut” nënkupton tërësinë e:

- a. Strategjive, me anë të të cilave përcaktohet qasja e shoqërisë së sigurimit për të trajtuar zonat të veçanta të rrezikut dhe detyrimet ligjore e rregullatore;
- b. Politikave, me anë të të cilave përcaktohen procedurat dhe kërkesat e tjera që janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, drejtuesit e lartë ekzekutivë, funksionarët kryesorë dhe punonjësit e shoqërisë së sigurimit;
- c. Proceseve, me anë të të cilave zbatohen strategjitë dhe politikat e shoqërisë së sigurimit; dhe
- d. Kontrolleve, me anë të të cilave sigurohet që strategjitë, politikat dhe proceset ekzistojnë, mbikëqyren dhe funksionojnë në përmbushje të objektivave.

4.2 Sistemi i administrimit të rrezikut shërben për të identifikuar, vlerësuar, mbikëqyrur, administruar dhe raportuar, në vijimësi, rreziqet me të cilat është përballur ose mund të përballlet, një shoqëri sigurimi në nivel të shoqërisë, si një e tërë, dhe në nivel grupi.

Neni 5

Elementët përbërës të sistemit të administrimit të rrezikut

5.1 Shoqëria e sigurimit ndërton një sistem efektiv për administrimin e rrezikut, duke u bazuar në natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, si dhe të kuadrit ligjor e rregullator në fuqi.

5.2 Sistemi i administrimit të rrezikut përbëhet, të paktën, nga elementët e mëposhtëm:

- a. Dokumenti strategjik i administrimit të rrezikut, i cili bazohet në strategjinë e përgjithshme të biznesit të miratuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes dhe në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, përfshi edhe çdo funksion të deleguar;
- b. Objektivat përkatëse, parimet kryesore dhe shpërndarja e duhur e përgjegjësiave për të trajtuar rrezikun në të gjithë veprimtarinë dhe njësitë organizative të shoqërisë së sigurimit, përfshi degët e saj;
- c. Niveli i pranueshëm i rrezikut, i përcaktuar qartë dhe i miratuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, duke u këshilluar me drejtuesit e lartë ekzekutivë;
- ç. Procedura të shkruara, që ndiqen për rastet e shmangies nga strategjia e administrimit të rrezikut ose niveli i pranuar i rrezikut, për qartësimin e çdo çështjeje të rëndësishme që kërkon interpretim, si dhe për miratimin e tyre nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes;
- d. Politika të përshtatshme, të shkruara dhe të miratuara nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, për përcaktimin dhe klasifikimin e rreziqeve të rëndësishme dhe që parashikohen në mënyrë të arsyeshme, sipas llojit, me të cilët përballlet shoqëria e sigurimit; si dhe nivelet e pranueshme për secilin lloj rreziku, të tilla si rreziku i sigurimit, i tregut, i kreditit, i likuiditetit, operacional, risigurimi, si dhe i llojeve të rreziqeve që krijohen nga marrëdhëniet brenda grupit, me palët e lidhura, transfertat apo transaksionet.

dh. Procese dhe mjete të përshtatshme, përfshi edhe modelet, kur është e mundur, për përcaktimin, vlerësimin, mbikëqyrjen, administrimin dhe raportimin e rreziqeve, si edhe planet e përbërës të situatave të paparashikuara, apo planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe administrimit të krizës;

e. Procedura, për shqyrtimin rregullisht të sistemit të administrimit të rrezikut dhe të elementëve përbërës të tij, për të kryer në kohë përshtatjet dhe përmirësimet e nevojshme.

Neni 6

Funksioni i administrimit të rrezikut

6.1 Funksioni i administrimit të rrezikut strukturohet në mbështetje të zbatimit të sistemit të administrimit të rrezikut. Në varësi të madhësisë së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, profilit të rrezikut dhe kompleksitetit të saj, shoqëria e sigurimit mund të krijojë struktura të posaçme për funksionin e administrimit të rrezikut, të tilla si njësia e administrimit të rrezikut, Komiteti i Administrimit të Rrezikut, dhe/ose të emërojë Drejtuesin e funksionit të Administrimit të Rrezikut ose të njësisë së administrimit të rrezikut.

6.2 Strukturat e administrimit të rrezikut mund të bashkohen edhe me funksione të tjera të kontrollit, përveç njësisë së auditimit të brendshëm, por në çdo rast ruhet pavarësia nga funksionet e biznesit, shmanget konflikti i interesit, sigurohet integriteti i funksioneve të tjera të kontrollit, nëpërmjet procedurave shtesë të kontrollit, si dhe ruhet raporti i kontrolleve dhe ekuilibrave.

6.3 Pavarësisht strukturës së përzgjedhur, funksioni i administrimit të rrezikut strukturohet i tillë, që të marrë parasysh se administrimi i rrezikut:

a. Trajtohet në nivel grupi, nivel shoqërie dhe nivel linje biznesi, por edhe në ndarje të tjera, sipas kategorive të ndryshme të rrezikut;

b. Është pjesë përbërëse e kulturës dhe mjedisit të punës në shoqërinë e sigurimit, në çdo nivel të saj dhe në mënyrë të integruar;

c. Mbështetet me politika dhe procese të shkruara me gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, që të gjithë punonjësit e shoqërisë së sigurimit të kenë mundësi të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me administrimin e rrezikut;

ç. Mbështetet me komunikim dhe trajnim të vazhdueshëm për politikat e administrimit të rrezikut;

d. Ka autoritet të plotë për marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për ushtrimin e detyrave funksionale;

dh. Mbështetet me linja raportimi, të cilat mundësojnë raportimin e shpejtë në situata që kërkojnë vëmendje urgjente, deri në nivelin më të lartë vendimmarrës të shoqërisë së sigurimit. Në këtë rast, Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes merr masa që raportimet të qendërzohen në një njësi apo drejtues të vetëm, që vlerëson këto raporte dhe formon një pamje të përgjithshme të sistemit të administrimit të rrezikut;

e. Ka mundësi komunikimi në Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes në lidhje me vlerësimin e ekspozimeve ndaj rrezikut dhe masat që duhen marrë për administrimin e tyre; vlerësimin e ndryshimit në profilin e rrezikut; vlerësimin e ngjarjeve të rrezikut, si dhe përcaktimin e veprimeve të përshtatshme për ndreqje të situatës.

Neni 7

Detyrat kryesore të funksionit të administrimit të rrezikut

Funksioni i administrimit të rrezikut vendos, zbaton dhe vë në veprim mekanizmat, si dhe kryen veprimtaritë e duhura për të:

- a. Mbështetur Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes dhe drejtuesit e tjerë ekzekutivë në përmbushjen e përgjegjësiave të tyre për administrimin e rrezikut;
- b. Përcaktuar rreziqet me të cilat përballen shoqëria e sigurimit;
- c. Vlerësuar, agreguar, mbikëqyrur dhe ndihmuar në administrimin dhe trajtimin me efektivitet të rreziqeve të përcaktuara;
- ç. Vlerësuar profilin tërësor të rrezikut të shoqërisë së sigurimit dhe aftësinë paguese, në nivel shoqërie sigurimi dhe nivel grupi. Vlerësimi i rrezikut dhe i aftësisë paguese është pjesë përbërëse e strategjisë së biznesit të shoqërisë së sigurimit dhe merret parasysh në vazhdimësi në vendimet strategjike të shoqërisë, si dhe është pjesë e opinionit të auditimit ligjor;
- d. Vlerësuar në vijimësi mjedisin e rrezikut brenda dhe jashtë shoqërisë së sigurimit për të përcaktuar dhe vlerësuar rreziqet e mundshme sa më shpejt të jetë e mundur, duke i shqyrtuar rreziqet sipas njësive territoriale dhe sipas linjës së biznesit;
- dh. Shqyrtuar rreziqet që krijohen prej modeleve të dhënies së shpërblimeve dhe të nxitësve të tjerë;
- e. Kryer rregullisht provat e rezistencës dhe analizat e skenarëve;
- ë. Raportuar rregullisht te drejtuesit e lartë ekzekutivë, funksionarët kryesorë, Komitetet dhe në Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes për profilin e rrezikut dhe elementët e tjerë që lidhen me rreziqet, me të cilat përballen shoqëria e sigurimit, si edhe masat e marra për pakësimin e rreziqeve;
- f. Dokumentuar dhe raportuar në Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes ndryshimet e rëndësishme që ndikojnë në sistemin e administrimit të rrezikut, me qëllim që të përmirësohet ky sistem;
- g. Kryer rregullisht vlerësime për efektivitetin e sistemit të administrimit të rrezikut dhe funksionimit të tij, si edhe për të zbatuar e mbikëqyrur përmirësimet e nevojshme;
- gj. Këshilluar Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes në lidhje me vendimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me çështje operationale dhe strategjike, si strategjia e shoqërisë, vendime për bashkime dhe blerje apo dhe investime e projekte madhore.

Neni 8

Përgjegjësia/të e Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrjes

Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes ka përgjegjësi:

- a. Për t'u siguruar se në shoqërinë e sigurimit janë ndërtuar sisteme dhe funksione të përshtatshme për administrimin e rrezikut;
- b. Për mbikëqyrjen e sistemit të administrimit të rrezikut, si dhe për t'u siguruar që sistemi funksionon me efektivitet dhe në përputhje me objektivat;
- c. Për të miratuar politikën e administrimit të rrezikut dhe krijimin e kulturës së integruar për administrimin e rrezikut në shoqëri;
- ç. Për të siguruar, që shoqëria e sigurimit kryhen të paktën një herë në vit vlerësimin e rrezikut dhe të aftësisë pague, përveç kërkesave minimale të legjislacionit në fuqi. Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrës njoftohet në kohë për këtë vlerësim dhe përcakton sasinë e kapitalit minimal, në rastin kur është më i lartë se minimumi ligjor i kërkuar, për shoqërinë e sigurimit, që të operojë në kushte të sigurta dhe merr masat që këto kërkesa të përmbushen;
- d. Për të shqyrtuar dhe ndryshuar politikën e administrimit të rrezikut të paktën një herë në vit dhe sa herë që gjykohet e nevojshme;
- dh. Për të ngritur dhe garantuar funksionin e pajtueshmërisë, si funksion këshillues për Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrës. Funksioni i pajtueshmërisë këshillon Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrës dhe drejtuesit e lartë ekzekutiv për pajtueshmërinë me legjislacionin përkatës dhe vlerëson ndikimin që çdo ndryshim në kuadrin rregullator ka në veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 9

Komitetet e Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrjes

9.1 Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, në përmbushje të përgjegjësiave për mbikëqyrjen e funksionimit me efektivitet të sistemit të administrimit të rrezikut, përveç komiteteve të përmendura në ligjin e sigurimeve, mund të krijojë komitete të tjera të veta, përfshi edhe komitetin e administrimit të rrezikut.

9.2 Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, për çdo komitet të krijuar miraton rregulloren e funksionimit të komitetit, ku përcaktohen qartë përbërja, objektivat, detyrat, përgjegjësitë, kompetencat, organizimi i mbledhjeve dhe raportimi. Rregullorja e komitetit shqyrtohet rregullisht nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes.

9.3 Komiteti i krijuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes:

- a. Mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme, kur gjykohet e nevojshme nga vetë Komiteti ose nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes;

b. Mban procesverbalin e mbledhjeve dhe të vendimeve të marra nga Komiteti, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje;

c. Ka të drejtën të kërkojë mbledhje të jashtëzakonshme me të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrjes në rastet kur zbulojnë se ekzistojnë ngjarje apo rrethana, të cilat në të ardhmen mund të ndikojnë për keq (negativisht) në gjendjen financiare të shoqërisë së sigurimit;

ç. Raporton në Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes, në mbledhjen e radhës që zhvillohet menjëherë pas mbledhjes së Komitetit. Në raport përfshihet çdo rekomandim që gjykohet se ka nevojë të shqyrtohet nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes.

Neni 10

Komiteti i Administrimit të Rrezikut

10.1 Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes, në varësi të natyrës dhe madhësisë së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit dhe të rreziqeve me të cilat përballlet ajo, mund të krijojë Komitetin e Administrimit të Rrezikut, nëse e gjykon të përshtatshëm.

10.2 Komiteti i Administrimit të Rrezikut ka për detyrë të mbështesë Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes, për ndërtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikës të shoqërisë për administrimin e rrezikut.

10.3 Komiteti i Administrimit të Rrezikut ka këto detyra:

a. Shqyrton dhe vlerëson rregullisht politikën, strategjitë, kufijtë dhe proceset që kanë të bëjnë me administrimin e rrezikut në shoqërinë e sigurimit, si dhe jep rekomandime për Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes në lidhje me miratimin e tyre, apo çdo ndryshim të tyre që gjykohet i përshtatshëm;

b. Siguron që politikën, strategjitë, kufijtë dhe proceset e miratuara për administrimin e rrezikut në shoqërinë e sigurimit janë në harmoni me strategjinë e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, të miratuar nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes;

c. Mbështet Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes për t'u siguruar që programi i administrimit të rrezikut të shoqërisë së sigurimit zbatohet në përputhje me politikën, strategjitë, kufijtë dhe proceset e miratuara nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes dhe me kuadrin ligjor e rregullator përkatës në fuqi;

ç. Mbikëqyr zbatimin e politikave, strategjive, kufijve dhe proceseve, përmes raporteve që merr nga drejtuesit e lartë ekzekutivë dhe/ose njësia e administrimit të rrezikut të shoqërisë së sigurimit, në rastet kur ekziston një e tillë;

d. Raporton në Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes për efektivitetin e proceseve të administrimit të rrezikut të shoqërisë së sigurimit;

dh. Përmbush detyra të tjera që i caktohen nga Këshilli i Administrimit/Mbikëqyrjes në lidhje me programin e administrimit të rrezikut të shoqërisë së sigurimit;

e. Mblidhet të paktën një herë në tre muaj në mbledhje të rregullt, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme, nëse gjykohet e nevojshme.

10.4 Një pjesë ose të gjitha përgjegjësitë e Komitetit të Administrimit të Rrezikut, me vendim të Këshillin e Administrimit/Mbikëqyrjes, mund t'i delegohen Komitetit të Auditimit.

Neni 11

Dokumentimi dhe raportimi

11.1 Shoqëria e sigurimit dokumenton çdo fazë dhe veprim të procesit të vlerësimit të rrezikut dhe të kryerjes së provave të rezistencës, në formë të tillë që përdoruesi i dokumentacionit të arrijë në të njëjtat përfundime.

11.2 Shoqëria e sigurimit paraqet brenda datës 31 maj të çdo viti në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare raportin vjetor mbi vlerësimin e rreziqeve të shoqërisë dhe kryerjes së provave të rezistencës.

11.3 Raportimi i parë për procesin e vetëvlerësimit të rreziqeve të shoqërisë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare fillon në vitin 2016.

Neni 12

Përmbajtja e raportit vjetor për vlerësimin e rreziqeve

12.1 Raporti vjetor për vlerësimin e rreziqeve paraqet rezultatet kryesore në procesin dhe metodologjinë e vlerësimit të rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohet shoqëria e sigurimit; supozimet bazë të përdorura për kryerjen e provave të rezistencës dhe rezultatet e tyre; vlerësimin e ushtrimit të përgjegjësisë nga ana e strukturave përkatëse për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut; rekomandimet e parashtruara, masat ndreqëse të përcaktuara në bazë të rekomandimeve, dhe nivelin e zbatimit të tyre; si dhe nivelin minimal të kapitalit në raport me profilin e rrezikut.

12.2 Raporti vjetor përmban të paktën informacionin e kërkuar, në nivel shoqërie sigurimi dhe/ose grupi, dhe të shpjeguar si më poshtë:

a. *Kuadri i administrimit të rrezikut.* Në këtë pjesë përshkruhen struktura qeverisëse dhe strukturat përkatëse përgjegjëse, të krijuara për të ushtruar funksionin e administrimit të rrezikut; komitetet e krijuara dhe funksionimi i tyre; politika në drejtim të pranimi dhe administrimit të rrezikut; objektivat strategjike dhe ato specifike vjetore.

b. *Kategoritë e rreziqeve.* Në këtë pjesë përshkruhen kategoritë e rreziqeve të identifikuara.

c. *Kuadri i raportimit.* Në këtë pjesë përshkruhen kërkesat ligjore, rregullatore dhe të standardeve të tjera, që gjejnë zbatim, në lidhje me raportimin e rreziqeve, si dhe përshkrimin e metodologjisë së miratuar për vlerësimin e klasifikimin e rreziqeve dhe kryerjen e provave të rezistencës.

ç. *Administrimi i kapitalit.* Në këtë pjesë përshkruhen kërkesat ligjore, rregullatore dhe të standardeve në lidhje me nivelin minimal të kapitalit dhe veprimet e vlerësimet për të arritur në nivelin e mjaftueshëm të kapitalit në përputhje me profilin e rrezikut.

d. *Rreziqet.* Në këtë pjesë përshkruhen në mënyrë të hollësishme metodat, supozimet përcaktimet, vlerësimi dhe mbikëqyrja e çdo kategorie rreziku të identifikuar, provat e rezistencës të kryera për çdo kategori, së bashku me supozimet dhe rezultatet, si dhe niveli i kapitalit që i përgjigjet nivelit të vlerësuar të rrezikut për kategorinë përkatëse.

dh. *Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara.* Në këtë pjesë përshkruhen në mënyrë të hollësishme planet e hartuara dhe të miratuara nga shoqëria për të siguruar vijueshmërinë e veprimtarinë, për të përballuar situatat e paparashikuara, për të rifilluar veprimtarisë, pasi rreziqet janë materializuar apo ngjarjet me efekt të dëmshëm kanë ndodhur; si dhe rezultatet e testeve të kryera.

e. *Rekomandimet dhe masat.* Në këtë pjesë përshkruhen raportimet, rekomandimet dhe masat e mara për të administruar rreziqet nga strukturat përkatëse.

ë. *Përfundimi.* Në këtë pjesë përshkruhet profili i përgjithshëm i rrezikut, si dhe masat që do të merren për vitin në vijim.

Neni 13

Sistemi i administrimit të rrezikut për grupin

Të gjitha përcaktimet e kësaj rregulloreje në lidhje me ndërtimin, funksionimin dhe përmirësimin e sistemit të administrimit të rrezikut zbatohen edhe për grupin.

Neni 14

Dispozitë kalimtare për procesin e testimit

14.1 Shoqëria e sigurimit merr masa për të testuar gjatë vitit 2015 vetëvlerësimin e rreziqeve, kryerjen e provave të rezistencës dhe përcaktimin e nivelit të aftësisë paguese, si dhe, mbi këtë bazë, të përmirësojë sistemet e vlerësimit dhe të administrimit të rreziqeve.

14.2 Shoqëria e sigurimit përgatit planin e testimit të vetëvlerësimit dhe e raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, brenda muajit shtator 2015.

14.3 Shoqëria e sigurimit dokumenton çdo hap të këtij procesi testimi dhe raporton në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare rezultatet e testimit brenda muajit maj 2016.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.